

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5812
E enjte, 27 qershor 2019
çmimi 0.40 €

Kosova edhe sivjet në
agjendën e AP-së për
anëtarësim në Interpol

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

**JETËSHKRIMI
I FATIT,
GUXIMIT DHE
SUKSESIT** F. 11

Prof. dr. Nusret
PLLANA



AKTUALE

**HARADINAJ MË 1 KORRIK
VIZITON PARISIN, NË
AGJENDË LIBERALIZIMI I
VIZAVE** F. 7

**NIS NDËRTIMI I NJË
ÇERDHEJE DHE NJË
SHKOLLE NË ISTOG** F. 10

EKONOMI

**KOSOVA DHE SHOIPËRIA,
MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NË FUSHËN E BIZNESEVE** F.9

**SHALA PARALAJMËRON TAKSË
PËR SHOIPËRINË DHE
MAQEDONINË E VERIUT** F.9

KULTURË

**RECENSION PËR LIBRIN E
ISH-PRESIDENTIT TË
SHOIPËRISË REXHEP
MEIDANI 'RENDI GLOBAL
DHE SHTETI KOMB'** F. 13

Sabri KIÇMARI



SPORT

**FAZLIU: E KALAJMË EDHE
SANTA COLOMAN** F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEHAR SELIMI | FAQE 4-5



Kriza e improvizuar humanitare në veri kërcënon stabilitetin

Njohësi i çështjeve të sigurisë, Behar Selimi, ka vlerësuar se niveli i sigurisë publike në Kosovë është i mirë dhe mund të krahasohet me vendet perëndimore. Por, ai ka thënë se siguria kombëtare vazhdon të jetë e kërcënuar.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Selimi ka theksuar se siguria kombëtare është jostabile përderisa Serbia pengon funksionimin normal të institucioneve shtetërore të Kosovës. Ai i ka quajtur shqetësues skenarët e fundit

të improvizimit të krizave humanitare në veri të Mitrovicës. Sipas Selimit, këta skenarë janë kërcënim për stabilitetin. Ai u ka bërë thirrje autoriteteve përgjegjëse që sa më shumë ta demaskojnë çdo propagandë të tillë

PSD-ja dhe Nisma kërkojnë që të mos anashkalohet ekipi negociator në dialog

FAQE 3

Dy subjektet politike që bashkëkryesojnë ekipin negociator të Kosovës për bisedime me Serbinë, PSD-ja dhe Nisma Socialdemokrate, kanë kritikuar qasjen e presidentit dhe të kryeministrit ndaj dialogut me Serbinë. Zyrtarët e lartë të këtyre dy subjekteve politike kanë bërë me dije se dy liderët shtetërorë kohën e fundit e kanë anashkaluar ekipin negociator në raport me dialogun. Sipas Haxhi Shalës



dhe Visar Ymerit, moskoordinimi i institucioneve për këtë proces e ka bërë të paqartë përfundimin e dialogut

Prezantohet projekti për qytetin ekonomik kosovaro- amerikan

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Meta: Aktorët e brendshëm ose të jashtëm do të mbajnë përgjegjësi

Presidenti Ilir Meta ka thënë se çdo veprim drejt rrugës së paligjshmërisë dhe të konfliktit e nxjerrë Shqipërinë nga perspektiva evropiane, njëkohësisht të gjithë aktorët e brendshëm ose të jashtëm që i kontribuojnë këtij skenari, do të mbajnë përgjegjësi përpara popullit shqiptar

TIRANË, 26 QERSHOR - Në takimin e zhvilluar me ministrin e Jashtëm të Hungarisë, Peter Szijjarto, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka folur edhe për situatën në vend, që vijon të jetë e tensionuar në

prag të zgjedhjeve të 30 qershorit. Meta ka kërkuar reflektimin e palëve sa më parë për dialog dhe zgjidhjen e krizës që po përjeton vendi dhe rikthimin në normalitetin e respektimit të shtetit ligjor.

Presidenti Meta vlerësoi marrëdhëniet tradicionalisht shumë të mira ndërmjet Shqipërisë dhe Hungarisë dhe potencialin e thellimit të tyre veçanërisht në aspektin ekonomik. Presidenti çmoi mbështetjen e sinqertë të Hungarisë në procesin e integritit evropian dhe veçanërisht për çeljen sa më parë të negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian.

Kreu i shtetit theksoi rëndësinë që ka zbatimi i të gjitha prioritetëve që kushtëzojnë një vendim pozitiv të Këshillit Evropian vjeshtën e ardhshme,

duke nënvizuar reflektimin e palëve sa më parë për dialog dhe zgjidhjen e krizës që po përjeton vendi dhe rikthimin në normalitetin e respektimit të shtetit ligjor. "Çdo veprim drejt rrugës së paligjshmërisë dhe të konfliktit e nxjerrë Shqipërinë nga perspektiva e saj evropiane, njëkohësisht të gjithë aktorët e brendshëm ose të jashtëm që i kontribuojnë këtij skenari, do të mbajnë përgjegjësi përpara popullit shqiptar", theksoi presidenti Meta gjatë këtij takimi.

Ndërkaq kryeministri Rama gjatë takimit elektoral në Gramsh, teksa prezantoi kandidatin për kryetar bashkie, u rikthye tek ajo që ka ndodhur në Parlament përpara se opozita t'i digjte mandatet. Sipas Ramës, "nuk ishte parë që një deputete ta hiqte çizmen dhe të gjuante në mes të Parlamentit, apo të vinin me xhupa të mbushur me vezë, duke bërë atë që kurrë nuk mund të bëhen në parlament".

Rama u rikthye edhe te përgjimet e publikuara në "Bild", për të cilat tha se ishin një çorbë e neveritshme e politikës shqiptare, e një partie që bojkotoi zgjedhjet.

Ndërkohë, Partia Demokratike ka prezantuar strategjinë e saj për zgjedhjet e 30 qershorit, por edhe pas tyre. Burime nga kjo parti bëjnë të ditur se protestat do të shtrihen në të 61 bashkitë e vendit "në mbrojtje të demokracisë dhe rendit kushtetues dhe kundër farsës së votimeve të paligjshme". "Ditët e ardhshme, duke kulmuar më 30 qershor dhe pas kësaj date, do të jenë ditë

protestash në të gjithë vendin. Opozita dhe qytetarët do të protestojnë në të 61 bashkitë e vendit në mbrojtje të demokracisë dhe rendit kushtetues dhe kundër farsës së votimeve të paligjshme.

Në bashkëpunim me aleancën qytetare në mbrojtje të demokracisë, Partia Demokratike dhe aleatët e opozitës së bashkuar kanë njoftuar protesta në të gjitha bashkitë kundër votimeve njëpartiake, në kundërshtim me Kushtetutën. Protestat vënë në dukje bashkëpunimin e Edi Ramës me bandat e drogës dhe krimin të organizuar. Protestat do të shtrihen në të gjithë vendin dhe, sipas informacioneve, do të zhvillohen në sheshe qendrore dhe pranë KZAZ-ve", thuhet në njoftimin e PD-së.

Këshilli i Evropës ka anuluar misionin vëzhgues për zgjedhjet në Shqipëri. Shkak i këtij vendimi është bërë paqartësia në procesin zgjedhor në shtetin shqiptar. "Këshilli i Evropës ka vendosur ta anulojë delegacionin e Kongresit për vëzhgimin e zgjedhjeve në Shqipëri për shkak të paqartësisë së vazhdueshme në lidhje me organizimin e zgjedhjeve lokale në Shqipëri më 30 qershor si dhe rreziqet e mundshme të sigurisë në zona të caktuara ku do të mbahen zgjedhjet. Ju kërkohet ndjesë për çdo shqetësim që mund të ketë shkaktuar anulimi në çastet e fundit dhe ju falënderojmë për gatishmërinë për të bashkëpunuar me Kongresin", ka njoftuar Këshilli i Evropës, raportojnë mediet në Shqipëri.



ShBA: Zgjedhjet e 30 qershorit të jenë paqësore

TIRANË, 26 QERSHOR - ShBA-ja ka paralajmëruar se zgjedhjet e kësaj fundjave në Shqipëri duhet të zhvillohen paqësisht, përndryshe opozita e vendit do të klasifikohet si "organizatë e dhunshme", shkruan "EUreporter", platforma e lajmeve multimediale evropiane me bazë në Bruksel. Në shkirimin kushtuar situatës politike në vend, "EUreporter" risjell në vëmendje apelin njëzëri të ShBA-së dhe BE-së se zgjedhjet duhet të mbahen më 30 qershor.

Nënkryetari i misionit të Ambasadës Amerikane në Shqipëri, Daniel Koski, tha se "çdo akt dhune nga dita e sotme deri më 1 korrik do ta detyrojë

Departamentin Amerikan të Shtetit t'ju klasifikojë si organizatë të dhunshme".

Mesazhi i fortë i drejtohet PD-së, që konsiderohet fajtorë për problemet që po kalon vendi si në marrëdhëniet e brendshme, po ashtu edhe në ato ndërkombëtare. Pavarësisht prej bojkotit dhe përpjekjeve të presidentit Ilir Meta për t'i anuluar zgjedhjet vendore, ato do të zhvillohen këtë të diel. Dekreti i presidentit Meta për anulimin u rrezua nga Kolegji Zgjedhor.

Prej disa muajsh opozita ka organizuar protesta, disa prej të cilave u përshkallëzuan në dhunë. Televizioni shqiptar "Top

Channel" ka raportuar se opozita është paralajmëruar nga Departamenti Amerikan i Shtetit se PD-ja do të klasifikohet si "organizatë e dhunshme" nga ShBA-ja nëse dhuna vazhdon.

Një eurodiplomat theksoi se "kjo është një deklaratë shumë serioze dhe vetëm një shkallë më poshtëse klasifikimi si organizatë terroriste". Shqipëria po përjeton një krizë politike prej disa muajsh, ndërsa kthesa e fundit e ngjarjeve erdhi së fundmi nga një telefonatë e kryeministrit amerikan Philip T. Reeker, zëvendëssekretar për Euroazinë në Departamentin Amerikan të Shtetit.



Partia Socialdemokrate dhe Nisma Socialdemokrate janë hatëruar me krerët e shtetit rreth dialogut me Serbinë

PSD-ja dhe Nisma kërkojnë që të mos anashkalohej ekipi negociator në dialog



Dy subjektet politike që bashkëkryesojnë ekipin negociator të Kosovës për bisedime me Serbinë, PSD-ja dhe Nisma Socialdemokrate, kanë kritikuar qasjen e presidentit dhe kryeministrit ndaj dialogut me Serbinë. Zyrtarët e lartë të këtyre dy subjekteve politike kanë bërë me dije se dy liderët shtetërorë kohët e fundit e kanë anashkaluar ekipin negociator në raport me dialogun. Sipas Haxhi Shalës dhe Visar Ymerit, moskoordinimi i institucioneve për këtë proces e ka bërë të paqartë përfundimin e dialogut

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Partia Socialdemokrate dhe Nisma Socialdemokrate, liderët e të cilave udhëheqin ekipin negociator, nuk pajtohen me qasjen e presidentit dhe kryeministrit për dialogun Kosovë - Serbi. Zyrtarët e lartë të këtyre dy partive kanë kritikuar presidentin Hashim Thaçi dhe kryeministrin Ramush Haradinaj për protagonizëm dhe mospërfillje të ekipit negociator në Samitin e Berlinit dhe në përgatitjen e Samitit të Parisit, mbajtja e të cilit ka dështuar.

Deputeti i Nismës Socialdemokrate, Haxhi Shala, ka thënë se platforma dhe ligji për dialogun caktojnë në

mënyrë të qartë se kush e ka mandatin për bisedime Kosovë - Serbi. "Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e dizajnuar për ta ndarë fuqinë e pushtetit, i ndanë qartë kompetencat e zyrës së kryeministrit dhe të presidentit, por asnjëra nga këto zyra nuk kanë të drejtë të interferojnë me pozicionet e tyre për çështje të tjera në të cilat nuk kanë mandat të plotë, aq më pak kur ekipi negociator ka legjitimitetin nga Kuvendi i Kosovës si organi më i lartë shtetëror i zgjedhur në mënyrë demokratike", ka vlerësuar Shala.

Ai ka bërë me dije se, sipas Kushtetutës, presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës, ndërsa

kryeministri i Kosovës ka pushtet të mjaftueshëm, por jo absolut. "Kryeministri mund të marrë iniciativa dhe t'i implementojë ato konform ligjit dhe rregulloreve të punës, por në raste kur temë diskutimi është dialogu Kosovë - Serbi, të paktën pjesë e tryezës do të duheshin të ishin të deleguarit e ekipit negociator si ekip i legjitimuar nga Kuvendi i Kosovës për temën në fjalë, me një statut dhe platformë për bisedime", ka thënë Shala. Sipas tij, moskoordinimi i krerëve të shtetit me ekipin negociator mjegullon përfundimin e procesit të dialogut. "Me këtë rast kjo nuk do të thotë se unë dua vetëm ta favorizoj partinë Nisma Socialdemokrate pjesë e së cilës jam. Si deputetë të Republikës së Kosovës, ne

jemi këtu t'i përfaqësojmë dinjitetshëm interesat e qytetarëve tanë. Veprime të tilla të moskoordinimit të krerëve të shtetit me ekipin negociator do ta mjegullonin përfundimin e këtij dialogu. Deri më tani çdo marrëveshje e bërë, vështirë është korrigjuar në interes të vendit tonë. Pastaj le t'i aneksojmë me dokumente të tjera marrëveshjet e nënshkruara, por realiteti do të ndryshonte", ka deklaruar Shala.

Një ditë më parë edhe Visar Ymeri, deputet i PSD-së dhe anëtar i delegacionit shtetëror të Kosovës për bisedime me Serbinë, ka bërë me dije se ky delegacion nuk ka qenë fare i përfshirë as në takimin e Berlinit dhe as në përgatitjet e takimit të Parisit i cili ka dështuar të mbahet. Në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se kjo qasje e ka dëmtuar Kosovën dhe duhet të ndalet. "Ndërsymja protagoniste ka qenë tejet e dëmshme në secilën nevojë dhe secilin aktivitet të politikës së jashtme të Kosovës. Këtë protagonizëm e personalizim të politikës e kemi parë të shquhet shumë

nga presidenti Thaçi (UNESCO, takimet me Vuçiçin e idetë që dilnin nga këto), ndërkohë edhe nga kreu i qeverisë, Haradinaj. Kjo qasje e ka dëmtuar Kosovën. Prandaj nuk duhet vazhduar kështu", ka thënë Ymeri.

Ai ka bërë me dije se dialogu dhe marrëveshja me Serbinë janë çështje tejet të ndjeshme dhe të rëndësishme për të ardhmen e Republikës së Kosovës. Sipas tij, këto çështje nuk duhet të diskutohen në takime të fshehta. "Takimet e mëhershme të presidentit Thaçi, për të cilat dëgjonim vetëm në formën e ideve të diskutuara dhe këto tashmë të përfaqësuesve të kryeministrit, nuk janë të pranueshme, të dobishme dhe të shëndosha. Përfaqësimi politik, e veçanërisht ai institucional në Kosovë, duhet ta kuptojë demokracinë jo si fjalë boshe dhe as vetëm si procedurë, por si sistem kompleks dhe legjitim i vendimarrjes", është shprehur Ymeri, duke shtuar se takimet larg syve të publikut janë e kundërta e demokracisë dhe nuk i shërbejnë interesit të përgjithshëm.

Ministri Mustafa i përkushtuar për zgjidhjen e problemeve për qytetarët e Luginës

PRISHTINË, 26 QERSHOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësues të qytetarëve me origjinë nga Lugina e Preshevës të kryesuar nga Fikrim Mehmeti. Në këtë takim u diskutua për çështjet që

shqetësojnë qytetarët nga Lugina e Preshevës të cilët jetojnë dhe punojnë në Kosovë. Ministri Mustafa ka shprehur gatishmërinë e tij që ministria të cilën e drejton do t'u ofrojë zgjidhje për problemet e tyre në bazë të kompetencave që ka si dhe

mbetet i përkushtuar për ofrimin e sigurisë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Gjithashtu, u diskutua edhe për problemet rreth dokumentacionit për qytetarët e Luginës së Preshevës, sidomos për nxënësit dhe studentët.



Flet për "Epokën e re", Behar Selimi

Kriza e improvizuar humanitare



Njohësi i çështjeve të sigurisë, Behar Selimi, ka vlerësuar se niveli i sigurisë publike në Kosovë është i mirë dhe mund të krahasohet me vendet perëndimore. Por, ai ka thënë se siguria kombëtare vazhdon të jetë e kërcënuar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Selimi ka theksuar se siguria kombëtare është jostabile përderisa Serbia pengon funksionimin normal të institucioneve shtetërore të Kosovës. Ai i ka quajtur shqetësues skenarët e fundit të improvizimit të krizave humanitare në veri të Mitrovicës. Sipas Selimit, këta skenarë janë kërcënim për stabilitetin. Ai u ka bërë thirrje autoriteteve përgjegjëse që sa më shumë ta demaskojnë çdo propagandë të tillë

improvizimit të krizave humanitare në veri të Mitrovicës dhe inkurajoj që sa më shumë të demaskohet çdo propagandë e tillë. Druaj se në këtë lojë është edhe e ashtuquajtura Qendra Ruso-serbe për Kriza Humanitare. Prandaj skenari i krizës së improvizuar humanitare në veri është kërcënim për stabilitetin", ka deklaruar Selimi. Kurse sa i përket nivelit të sigurisë publike në Kosovë, ai ka thënë se është i mirë dhe mund të krahasohet me vendet perëndimore.

Selimi ka folur edhe për vazhdimin e afatit për legalizim të armëve, me ç'rast ka thënë se ky është një vendim i mençur i Ministrisë së Punëve të Brendshme i cili mund të ndikojë në rritjen e sigurisë, sidomos të sigurisë humane. "Në këtë lloj të sigurisë ka ndikim qoftë edhe një armë ilegale më pak", është shprehur ai, duke shtuar se për të pasur suk-

ses ky proces duhet të përshpejtohen procedurat. "Po, ky është trendi i zakonshëm në çdo përpjekje apo fushatë legalizimi tek ne prej çlirimit e deri më sot. Pra, me përjashtim të periudhës së parë menjëherë pas luftës kur ka pasur një grumbullim më të madh armësh, por jo edhe legalizim, në periudhat e tjera trendi sillet rreth 2 000 kërkesa dhe shumë më pak legalizime. Mbase procedurat e legalizimit duhen përshpejtuar, njëkohësisht duhet të krijohet opinion i drejtë se kërkesat kryesisht për legalizim plotësohen në të mirë të palëve dhe në procedura të lehta", ka theksuar Selimi.

Ish-shefi i policisë e ka komentuar edhe përpjekjen e Kosovës për t'u bërë pjesë e Interpolit duke thënë se vendi ynë i plotëson kushtet për të qenë anëtarë e kësaj organizate. "Vështirë të parashikosh meqë është çështje politike dhe e varur nga vullneti

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Njohësi i çështjeve të sigurisë dhe ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Behar Selimi, ka thënë të mërkurën se skenari për improvizimin e krizës humanitare në veri është kërcënim për stabilitetin në vend.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se siguria kombëtare vazhdon të jetë e kërcënuar për aq kohë sa Serbia pengon funksionimin normal të shtetit të Kosovës. "Pra, për sa kohë që Serbia, e përkrahur nga Rusia, manipulon politikanë lokalë serbë, pengon funksionimin normal të institucioneve tona

shtetërore, lokale dhe qendrore në veri dhe jo vetëm, konsideroj se siguria kombëtare është jostabile. Integriteti territorial është i mbrojtur si mos më mirë (KFOR-i është përgjegjës), por i kërcënuar vazhdon të mbetet ushtrimi i plotë i sovranitetit kudo dhe ndaj çdokujt brenda territorit tonë. Janë shumë shqetësues skenarët e fundit të

në veri kërcënon stabilitetin

edhe kërkojnë inkurajim shtesë për të qenë në mbledhje meqë zakonisht mungojnë. Pra, kërkohet shumë punë konkrete dhe hiç lajme për lavdi", është shprehur Selimi.

"Epoka e re": Z. Selimi, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka vazhduar edhe për tre muaj afatin për legalizimin e armëve. Si e shihni këtë proces dhe sa mund të ndikojë në rritjen e sigurisë në vendin tonë?

Selimi: Vazhdimin e afatit për legalizim të armëve e konsideroj vendim të mençur të Ministrisë së Punëve të Brendshme i cili mund ta rrisë numrin e kërkesave për legalizim dhe, së këndejmi, të ndikojë në rritjen e sigurisë, sidomos të sigurisë humane. Në këtë lloj të sigurisë ka ndikim qoftë edhe një armë ilegale më pak.

"Epoka e re": Megjithatë, deri më tani një numër i vogël i qytetarëve ka bërë kërkesë për legalizim. Sipas të dhënave të fundit, janë 1 428 kërkesa, prej të cilave 682 janë aprovuar dhe të tjerat janë në proces.

Selimi: Po, ky është trendi i zakonshëm në çdo përpjekje apo fushatë legalizimi tek ne prej çlirimit e deri më sot. Pra, me përjashtim të periudhës së parë, menjëherë pas luftës, kur ka pasur një grumbullim më të madh armësh, por jo edhe legalizim, në periudhat e tjera trendi sillet rreth 2 000 kërkesa dhe shumë më pak legalizime. Mbase procedurat e legalizimit duhen përsheptuar, njëkohësisht duhet të krijohet opinion i drejtë se kërkesat, kryesisht për legalizim, plotësohen në të mirë të palëve dhe në procedura të lehta.

"Epoka e re": Çfarë vlerësimi keni për situatën e sigurisë së përgjithshme në vend dhe si e komentoni skenarin e serbëve për krizë humanitare në veri?

Selimi: Personalisht mendoj se niveli i sigurisë publike në Kosovë është i krahasueshëm me vendet perëndimore. Pra, është i mirë. Por, e kërcënuar vazhdon të jetë ajo që quhet siguri kombëtare. Pra, për sa kohë që Serbia, e përkrahur nga Rusia, manipulon politikanë lokalë serbë, pengon funksionimin normal të institucioneve tona shtetërore, lokale dhe qendrore, në veri dhe jo vetëm, konsideroj se siguria kombëtare është jostabile. Integriteti territorial është i mbrojtur si mos më mirë (KFOR-i është përgjegjës), por i kërcënuar vazhdon të mbetet ushtrimi i plotë i sovranitetit kudo dhe ndaj çdokujt brenda

territorit tonë. Janë shumë shqetësues skenarët e fundit të improvizimit të krizave humanitare në veri të Mitrovicës dhe inkurajoj që sa më shumë të demaskohet çdo propagandë e tillë. Druaj se në këtë lojë është edhe e ashtuquajtura Qendra Ruso-serbe për Kriza Humanitare. Prandaj, skenari i krizës së improvizuar humanitare në veri është kërcënim për stabilitetin.

"Epoka e re": Z. Selimi, zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) kanë bërë me dije se Komiteti Ekzekutiv i Interpolit ka vendosur që aplikacionin e Kosovës ta dërgojë për votim në Asamblenë e Përgjithshme të

Interpolit. Sa ka gjasa që Kosova këtë vit të pranohet në këtë organizatë?

Selimi: Vështirë të parashikosh meqë është çështje politike dhe e varur nga vullneti individual i secilit shtet anëtar. Pastaj ndikimi ruso-serb në këtë organizatë, bashkë me Kinën, nuk është i vogël. Pra, kushdo që e trajton këtë temë duhet ta ketë parasysh se është një OKB në miniaturë, duke përfshirë edhe raportin e forcave politike dhe ndikimet e tyre në vendimmarrje. Ajo në çka jam i sigurt është se shteti ynë i përmbushë të gjitha kriteret për anëtarësim dhe tash e sa vjet nëpërmjet UNMIK-ut dhe EULEX-it i ka ndihmuar shumë kësaj organizate për

arritjen e qëllimeve të saj. Pra, ne i kemi dhënë shumë Interpolit ende pa qenë anëtar. Sidoqoftë, brenda kësaj organizate ka ndikim.

"Epoka e re": Për ta realizuar këtë synim, cili duhet të jetë fokusi i shtetit të Kosovës?

Selimi: Duhet bërë lobim konkret pa shumë bujë dhe harxhime me shtetet që tanimë i dimë se cilat janë dhe pse kanë hezituar të votojnë herën e kaluar. Pastaj janë edhe disa shtete të vogla të cilat edhe kërkojnë inkurajim shtesë për të qenë në mbledhje meqë zakonisht mungojnë. Pra, kërkohet shumë punë konkrete dhe hiç lajme për lavdi.

Sëmundjet e rralla janë në listën e barnave esenciale

PRISHTINË, 26 QERSHOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka raportuar të mërkurën para Komisionit për Shëndetësi lidhur me procesin e revidimit të listës esenciale të barnave. Ismaili ka thënë se tashmë ka përfunduar e gjithë puna për revidimin e listës së barnave esenciale. Ministri Ismaili ka treguar se lista komplementare do të pasurohet me një numër më të madh të barnave për sëmundjet e rralla që përbëjnë një barrë të madhe financiare për pacientët. "Komiteti Teknik për revidimin e Listës së Barnave Esenciale ka përfshirë në listën e saj komplementare edhe barnat për sëmundjet e rralla në mënyrë që në të ardhmen numri i pacientëve që mbulohe me

terapi nga MSh të rritet", ka thënë ai.

Lista e Barnave Esenciale të cilën e sigurojnë institucionet publike për qytetarët ka qenë e pareviduar nga viti 2012.

Ministria e Shëndetësisë në vitin 2018 ka ngritur grupin e punës për hartimin e koncept-dokumentit për sëmundjet e rralla, duke synuar gjetjen e rrugës më të mirë dhe më pragmatike për t'i adresuar nevojat e këtij grupi të ndjeshëm të popullatës.

Koncept-dokumenti është hartuar dhe ka dalë në debat publik dhe brenda pak ditësh do të dërgohet në qeveri për miratim.

Pas aprovimit të koncept-dokumentit nga qeveria, Ministria e Shëndetësisë do të

vazhdojë menjëherë me grupin e punës për hartimin e planit të veprimit për institucionalizimin e përkujdesjes shëndetësore të pacientëve me sëmundje të rralla.

Ministri Ismaili ka bërë me dije së gjatë këtij viti do të blejnë pajisje mjekësore në vlerë prej 4.2 milionë eurosh. "Në vitin 2018, së bashku me ShSKUK-në, kemi blerë rreth 5 milionë euro pajisje për QKUK-në dhe spitalet e përgjithshme. E kemi gjetur Klinikën e Gastroenterologjisë pa gastrokop, sot i ka dy. Gjinekologjinë e kemi gjetur pa pajisje të duhura mjekësore, sot i ka shumicën", ka thënë ministri Ismaili gjatë raportimit në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi.



individual i secilit shtet anëtar. Pastaj ndikimi ruso-serb në këtë organizatë, bashkë me Kinën, nuk është i vogël. Pra, kushdo që e trajton këtë temë duhet ta ketë parasysh se është një OKB në miniaturë, përfshirë edhe raportin e forcave politike dhe ndikimet e tyre në vendimmarrje. Ajo në çka jam i sigurt është se shteti ynë i përmbushë të gjitha kriteret për anëtarësim dhe tash e sa vjet nëpërmjet UNMIK-ut dhe EULEX-it i ka ndihmuar shumë kësaj organizate për arritjen e qëllimeve të saj. Pra, i kemi dhënë shumë Interpolit ende pa qenë anëtar. Sidoqoftë, brenda kësaj organizate ka ndikim", ka thënë Selimi, duke shtuar se ky proces kërkon shumë punë. "Duhet bërë lobim konkret pa shumë bujë dhe harxhime me shtetet që tanimë i dimë se cilat janë dhe pse kanë hezituar të votojnë herën e kaluar. Pastaj janë edhe disa shtete të vogla të cilat

Prezantohet projekti për qytetin ekonomik kosovaro-amerikan

Kryeministri Ramush Haradinaj i ka prezantuar të mërkurën projektin për qytetin ekonomik kosovaro-amerikan kryetarit të Des Moines nga Iowa, Frank Cownie. Sipas Haradinajt, qyteti ekonomik kosovaro-amerikan është një mundësi e mirë për ofrimin e kushteve të nevojshme për investimet e kompanive të ndryshme nga ShBA-ja



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të mërkurën ka pritur në takim kryetarin e Des Moines nga Iowa, Frank Cownie, të cilit ia ka prezantuar projektin për qytetin ekonomik kosovaro-amerikan. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka njoftuar kryetarin Cownie për prioritetet e qeverisë në zhvillimin ekonomik, hapjen e vendeve të reja të punës dhe për mundësitë që ofron Kosova për investimet e huaja, veçmas ato nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA).

Duke falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e pazervë që i kanë dhënë Kosovës në të gjitha fazat e shtetndërtimit, kryeministri Haradinaj ka deklaruar se

në këtë fazë të konsolidimit ndërkombëtar të shtetësisë Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, hapjen e vendeve të reja të punës dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Më tutje, kryeministri Haradinaj ka treguar se Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë hapa konkretë për lehtësimin e procedurave dhe legjislacionit për investitorët e huaj potencialë si Ligjin për Investime Strategjike dhe një sërë lehtësirash tatimore që iu hapin rrugë investimeve të huaja. "Përcaktimi ynë për një miqësi dhe partneritet të përjetshëm me ShBA-në po dëshmohet çdoherë e më shumë me projekte konkrete siç është edhe qyteti ekonomik kosovaro-amerikan për të cilën qeveria po punon në vazhdimësi për ta shndërruar në storie suksesi për

zhvillim ekonomik të vendit dhe vlerë të shtuar të partneritetit tonë", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke potencuar faktin se Kosova ofron resurse natyrore, humane dhe infrastrukturë rrugore për investitorët dhe ndërmarrësit potencialë përtej Atlantikut që ta investojnë kapitalin e tyre në Kosovë.

Me qëllim të thellimit të bashkëpunimit ekonomik dhe tërheqjes së investimeve nga ShBA-ja, kryeministri Haradinaj ka thënë se qyteti ekonomik kosovaro-amerikan është një mundësi e mirë për ofrimin e kushteve të nevojshme për investimet e kompanive të ndryshme nga Shtetet e

Bashkuara të Amerikës. Ndërsa kryetari i Des Moines nga Iowa, Frank Cownie, ka vlerësuar bashkëpunimin ndërmjet Iowas dhe Republikës së Kosovës, duke thënë se ky bashkëpunim do të vazhdojë në fusha të ndryshme, si në: ekonomi, edukim, siguri dhe fusha të tjera të interesit të përbashkët.

KDI-ja: Tenderët për riparime kapitale në KEK, peng i kontratave të viteve '70

PRISHTINË, 26 QERSHOR (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) nëpërmjet një tryeze diskutimi ka shpalosur të mërkurën raportin nga monitorimi i kontratave për riparime kapitale në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK). Kjo korporatë gjatë vitit 2018 dhe 2019 ka dhënë tri kontrata për riparim dhe remont të pajisjeve që kapin vlerën rreth 11 milionë euro, me procedura të mbyllura dhe pa hulumtim të tregut. Kontratat për riparime të ngjashme tash e sa vite KEK-u i orienton te dy operatorë ekonomikë (që janë kompani të lidhura mes vete), që kanë qenë të përfshira në ndërtimin e termocentralit Kosova B qysh në vitet '70.



Blerim Gjoni nga KDI-ja gjatë prezantimit të raportit tregoi se janë analizuar tri kontrata të mëdha për riparime të turbinave dhe gjeneratorëve të cilat janë

dhënë me procedurë të negociuar dy operatorëve ekonomikë "GE Power" dhe "Alstom Power Services".

Këta operatorë ekonomikë, edhe

pse janë entitete të ndara, realisht janë kompani të lidhura pasi "GE Power" ka në pronësi kompaninë "Alstom Power Services". Këto dy kompani gjatë tre vjetëve të fun-

dit 2018, 2017 dhe 2016 së bashku kishin përfituar kontrata nga KEK në vlerë prej 22 milionë eurosh.

Të gjitha këto kontrata këtyre kompanive iu ishin dhënë përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit - procedurë jo e hapur ndaj tregut.

Gjoni ka theksuar se qëllimi i hulumtimit ka qenë vlerësimi i domosdoshmërisë së përdorimit të kontratave të negociuara nga KEK-u dhe nëse këto procedura janë zhvilluar në përputhje me ligjet e prokurimit publik. Për më tepër, janë analizuar mënyrat e zhvillimit të negociimit të KEK-ut me operatorët ekonomikë, në veçanti me operatorët të cilët mund të kenë monopol në ofrimin e këtyre shërbimeve apo furnizimeve.

Presidenti Thaçi priti një delegacion të komunitetit egjiptian

Prishtinë, 26 qershor (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të mërkurën ka pritur një delegacion të komunitetit egjiptian, të kryesuar nga deputeti Veton Berisha i Partisë Liberale Egjiptiane.

Presidenti Thaçi e ka uruar komunitetin egjiptian për Javën Egjiptiane, për 24 Qershorin, i cili nga ky vit është zyrtarisht Ditë Memoriale e Egjiptianëve, si dhe për aktivitetet e shumta gjatë javës së kaluar. "Një prej të arriturave

më të mëdha të Kosovës është integrimi i komuniteteve në shoqëri", u shpreh presidenti Thaçi.

Ndërsa deputeti Veton Berisha theksoi se Republika e Kosovës është shtet i gjithë egjiptianëve që

jetojnë këtu dhe të gjithë janë të interesuar të kontribuojnë sa më shumë që munden. Presidenti Thaçi i falënderoi pjesëtarët e komunitetit egjiptian për kontributin e vazhdueshëm në shoqërinë tonë.



Kosova edhe sivjet në agjendën e AP-së për anëtarësim në Interpol

Komiteti Ekzekutiv i Interpolit me seli në Lion (Francë) ka vendosur të mërkurën në favor të dërgimit të dosjes së Policisë së Kosovës për votim në Asamblenë e Përgjithshme të Interpolit, e cila këtë vit do të mbahet në Kili



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

LYON, 26 QERSHOR - Komiteti Ekzekutiv i Interpolit me seli në Lion të Francës ka debatuar të mërkurën rreth aplikacionit të Republikës së Kosovës dhe ka vendosur në favor të dërgimit të dosjes së Policisë së Kosovës për votim në Asamblenë e Përgjithshme të Interpolit e cila këtë vit do të mbahet në Kili. Policia e Kosovës u cilësua në nivelin më të lartë të profesionalizmit dhe kredibilitetit si organizatë policore moderne dhe me standarde të avancuara. Përbërja e Komitetit Ekzekutiv

për vitin 2019 nga gjithsej dhjetë shtete pjesëmarrëse në debatin e sotëm, ishin vetëm tri shtete të cilat e kanë njohur pavarësinë e vendit tonë dhe pothuajse të gjithë pjesëmarrësit argumentuan në favor të aplikacionit të Policisë së Kosovës për të proceduar më tutje në Asamblenë e Përgjithshme. Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, përmes një njoftimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka theksuar se Policia e Kosovës u cilësua në nivelin më të lartë të profesionalizmit dhe kredibilitetit si organizatë policore moderne dhe

me standarde të avancuara. Pacolli ka uruar që edhe Serbia të mos veprojë me obstrukcionet e saj kundër paqes dhe

sigurisë. "Do të ishte primitive dhe jashtë çdo logjike pengimi dhe lobimi kundër anëtarësimit të Policisë së Kosovës në

Organizatën Ndërkombëtare të Interpolit dhe, në anën tjetër, të flasësh për paqe dhe siguri", ka deklaruar Pacolli.

OVLUÇK-ja: Sabit Geci po maltretohet duke u mbajtur padrejtësisht nëpër burgje



PRISHTINË, 26 QERSHOR (ER) - Organizata e Veteranëve e Luftës së UÇK-së përmes një reagimi ka shprehur shqetësimet lidhur me rastin e veteranit Sabit Geci. "Organizata e Veteranëve e Luftës së UÇK-së është e shqetësuar për rastin e veteranit-invalidit të luftës, z. Sabit Geci, i cili është maltretuar kohë të gjatë, duke u mbajtur padrejtësisht nëpër burgje për shkak të gjyqimeve 'për krime luftime' që për ne ishin dhe janë procese të montuara politike. Duke e ditur gjendjen shëndetësore të z. Geci, i cili përballet me sëmundje të rënda, sëmundje të cilat janë edhe me diagnoza të njëjta nga ana e mjekëve të UNMIK-ut, EULEX-it, Turqisë dhe Kosovës, neve na ka ardhur mirë që drejtësia e liri gjashtë muaj për shkaqe shëndetësore", është thënë në reagimin e OVLUÇK-së, duke theksuar se

në lidhje me këtë rast janë habitur me reagimin e ambasadorit të ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett. "Lidhur me këtë lirim jemi habitur me reagimin e ambasadorit të ShBA-së në Kosovë, z. Philip Kosnett dhe pyesim se a ka të drejtë të përzihet në drejtësi, dhe pse nuk reagon për mosgjykimin e serbëve të cilët kanë bërë dhunime, djegie, shkatërrime dhe krime deri në gjenocid. Duke pasur parasysh që EULEX-i nuk ka më mandat për këto gjëra, pyesim: A kaq e paaftë është Prokuroria Speciale e Kosovës, që të dërgojë kërkesë në EULEX, për zbutje të dënimit të z. Geci, kur e di që kjo gjë në kompetencë të kujt është. Për fund: Ne mendojmë se vendorët dhe ndërkombëtarët kënaqen vetëm atëherë kur Sabit Geci është i vdekur", është theksuar në reagimin e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së.

Haradinaj më 1 korrik viziton Parisin, në agjendë liberalizimi i vizave

PRISHTINË, 26 QERSHOR (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Francës në Kosovë, Didier Chabert, me të cilin ka diskutuar për vizitën e tij zyrtare në Paris që do të realizohet më 1 korrik dhe për takimin që do të ketë me ministrin e Brendshëm të këtij shteti, Christophe

Castaner. "Me qëllim të koordinimit dhe avancimit të agjendës së Kosovës për liberalizimin e vizave dhe integrimin evropian, partneritetit bilateral politik dhe ekonomik me Francën, qeveria ka finalizuar përgatitjet dhe argumentet e saj të cilat ia paraqita ambasadorit Chabert dhe të cilat do t'i paraqesim edhe para zyr-

tarëve francezë. Në këtë vizitë do të zhvilloj takime edhe me përfaqësues të tjerë institucionale dhe politike të Francës me qëllim të thellimit të bashkëpunimit bilateral dhe kërkimin e mbështetjes për avancimin e agjendës evropiane të vendit", ka thënë Haradinaj pas takimit me ambasadorin francez.



Kosova dhe Shqipëria, memorandum bashkëpunimi në fushën e bizneseve

PRISHTINË, 26 QERSHOR (ER) - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, konkretisht Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Qendrën Kombëtare të Biznesit të Republikës së Shqipërisë.

Ministri i kësaj ministrie, Endrit Shala, ka thënë se nënshkrimi i këtij memorandum është forcimi i lidhjes së Kosovës dhe Shqipërisë dhe do të shërbejë për zhvillimin e ekonomisë, promovimin e inovacionit dhe shkëmbimin e teknologjisë. "Qëllimi i këtij memorandum mirëkuptimi është themelimi i një mekanizmi fleksibil dhe me fushë të gjerë për udhëzimin dhe bashkëpunimin e mëtejshëm ndërmjet palëve në fushën e regjistrimit të bizneseve, në përputhje me përgjegjësit e të dy agjencive në këtë fushë", ka thënë Shala.

Sipas tij, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, gjegjësisht

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, ka bërë disa ndryshime dhe në shkurt të këtij viti ka lansuar platformën e re elektronike për regjistrimin online të bizneseve, duke thjeshtuar procedurat dhe shkurtuar kohën për bizneset. "Kosova sot është një nga vendet në Evropë që biznesin mund ta hapësh për 24 orë, por ne do të vazhdojmë të krijojmë kushte edhe më të mira. Shqipëria për Kosovën është vend mike dhe çdo marrëveshje është e mirëpritur dhe do të ndikojë në shkëmbimin e përvojave duke konsideruar se memorandumet duhet të shtrihen edhe në fusha të tjera", ka thënë Shala. Ministri Shala I ka inkurajuar dy agjencitë të vazhdojnë bashkëpunimin në mënyrë që bizneset e Kosovës dhe të Shqipërisë të provohen dhe afrohen edhe më shumë.

Ky memorandum parasheh 11 fusha të bashkëpunimit, si: shkëmbimin e informacionit mbi



legislacionin në fushën e regjistrimit të bizneseve dhe reflektimet për përmirësimin e tij; shkëmbimin e publikimeve të

ndryshme në lidhje me fushën e regjistrimit të bizneseve, bashkëpunim në programet e trajnimit lidhur me regjistrimet e

bizneseve; bashkëpunim në fushën e regjistrimit të bizneseve dhe shërbimeve për publikun etj.

Shqyrtohen mundësitë e tejkalimit të mungesës së ujit në Gjilan

GJILAN, 26 QERSHOR (ER) - "Gjilani së bashku me nivelin qendror duhet të fokusohen në zgjidhje afatgjatë të çështjes së ujit të pijshëm, duke siguruar rezerva të tjera shtesë të ujit. Është hera e katërt që nga paslufta që Gjilani vjen në një situatë të tillë", është shprehur ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, gjatë tryezës me temë "Furnizimi afatgjatë i Gjilanit me ujë të pijshëm, shqyrtimi i alternativave për sigurimin e burimeve të ujit", organizuar nga Komuna e Gjilanit dhe Ujësjetësi Rajonal Hidromorava. Me këtë rast, ministri Lluka, i shoqëruar nga ministri i Mjedisit Fatmir Matoshi, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri dhe kryeshefi i Ujësjetësit Rajonal Hidromorava, Muhamed Suliqi, kanë vizituar Liqenin e Perlepnicsës për të shikuar nga afër se si rezervat ujore janë zvogëluar për shkak të



mungesës së reshjeve. Lluka ka pohuar se aktualisht

janë duke u analizuar katër burime emergjente që mund të

ndihmojnë në zgjidhjen e përkohshme të problemit, duke

shtuar se Gjilani së bashku me nivelin qendror duhet të fokusohen për zgjidhje afatgjatë të këtij problemi. "Sot është krizë ujore në Gjilan. Para pak kohe kemi pasur krizë të tillë në Prishtinë. Raporti i fundit i Bankës Botërore ka treguar qartë se Kosova ka vetëm 230 metër kub rezerva ujore për kokë banori, kurse vendet e rajonit mbi 650 metër kub, ndërsa shtetet e zhvilluara të Evropës, rreth 1700 m3 për kokë banori", është shprehur ministri Lluka gjatë tryezës, duke shtuar se në bazë të këtij raporti, Qeveria e Kosovës, me ndihmën e Bankës Botërore, është duke i trajtuar dy mundësi për investime siç janë: akumuluesi në Kamenicë dhe akumuluesi në Suharekë. Ministri Lluka, ministri Matoshi, së bashku me kryetarin Haziri, janë zotuar për t'i përkrahur rekomandimet e ekspertëve.

ZKA-ja nuk jep asnjë rekomandim për Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave

PRISHTINË, 26 QERSHOR (ER) - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) e Republikës së Kosovës ka publikuar Raportin e Auditimit për Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARH) për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018. Në këtë raport janë përmbled-

hur çështjet kryesore që dalin nga auditimi i pasqyrave financiare vjetore të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2018, i cili përfshin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare vjetore. Nga ky raport shihet se për ARH-në

nuk është potencuar asnjë e gjetur apo rekomandim, në asnjërin nga fushat e audituara, gjë dëshmon se menaxhimi dhe shfrytëzimi i parasë publike nga ARH është bërë në mënyrë profesionale, efikase dhe në përputhje të plotë me ligjet dhe rregulloret në fuqi.



Shala paralajmëron taksë për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut

Në debatin për efektet e taksës 100 për qind ndaj Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës, organizuar nga Instituti "Rinvest", ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka paralajmëruar taksë edhe për shtetet e tjera. Ai ka përmendur Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut ndaj të cilave prodhuesit e Kosovës kanë ankesë për disa taksa nga këto dy vende



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala (MTI), ka marrë pjesë në debatin "Talk the Talk" me temë "Efekti i taksës 100 për qind në ekonominë e vendit". Ministri Shala ka thënë se janë dy arsye të vendosjes së taksës që kanë ndikuar në ekonominë e vendit dhe në hapjen e vendeve të reja të punës. "Arsyet e vendosjes së taksës janë ekonomike dhe politike. Po ashtu, Serbia ka rrezikuar qenien e Republikës së Kosovës dhe sigurinë nacionale dhe jemi detyruar të marrim masa", ka thënë ministri Shala gjatë debatit. Ministri bëri me dije se masa ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës nuk do të hiqet pa e ndryshuar qasjen këto dy shtete karshi Republikës së Kosovës. "Serbia dhe Bosnja po e luftojnë qenien e Kosovës dhe po na bllokojnë në politikën e jashtme, në anëtarësimin

nëpër mekanizma ndërkombëtarë. Nuk ka arsye që masa të hiqet, por do të vazhdojë përderisa të mos largohen edhe arsyet pse është vendosur", është shprehur Shala. Ai ka pohuar se masa ka ndikuar që shumë prodhues vendorë kanë rritur prodhimin, kanë hapur vende të reja të punës dhe kanë rritur kualitetin e prodhimeve. "Të dhënat zyrtare tregojnë që ka pasur rritje të prodhimit dhe nuk ka pasur ngritje të çmimeve, përveç atyre që janë ndikuar në bursën ndërkombëtare. Përfitimet e Kosovës, veçanërisht të prodhuesve, janë të mëdha. Serbia është vendi i parë në rajon që vendos barriera ndaj Kosovës që nga paslufta. Ne nuk kemi vërejtur ngritje të çmimeve. Kjo masë e ka ndihmuar dhe

po e ndihmon rritjen e prodhimit vendor, hapjen e vendeve të reja të punës dhe ngritjen e kualitetit të produkteve vendore", është shprehur Shala. Ministri ka paralajmëruar masa edhe ndaj shteteve të tjera që janë duke iu vendosur barriera produkteve të Kosovës në rast se nuk e respektojnë marrëveshjen e CEFTA-s. "I kam paralajmëruar masat shumë shpejt që mund të merren ndaj vendeve të CEFTA-s, që e kanë shkelur marrëveshjen, do të marrim masa të njëjta. Së shpejti do të marrim masa edhe për pemë dhe perime, në mbrojtje të prodhimit vendor. Në dy takimet me Qeverinë e Shqipërisë kemi kërkuar largimin e dy taksave ndaj Kosovës. Edhe për

Maqedoninë kemi shqetësim nga prodhuesit kosovarë, sepse së fundi është ndaluar eksporti i prodhimit të lëndës së parë të peshkut. MTI-ja është e gatshme të marrë masa të caktuara ndaj shteteve të caktuara, varësisht nga kërkesat e prodhuesve kosovarë", ka thënë ai. Ministri Shala ka thënë se masa ndaj Serbisë dhe Bosnjës ka dëshmuar për herë të parë që Kosova është shtet dhe vendos vetë. Berat Thaçi nga Instituti GAP ka prezantuar të gjeturat e hulumtimit të këtij instituti lidhur me efektet e taksës 100 për qind. "Kosova nuk e ka shkelur CEFTA-n me tarifën 100 për qind për shkak se kryeministria e Serbisë e ka rrezikuar sigurinë kombëtare dhe marrëveshja e CEFTA-s

parasheh që një shtet që e bën këtë, shteti tjetër ka të drejtë ta pezullojë marrëveshjen. Kosova nuk mund të largohet nga CEFTA sepse është pjesë e marrëveshjes për Stabilizim Asociim. Mendoj se taksa nuk e ka ndihmuar ekonominë e vendit për përsheptim të deficitit tregtar. Taksa ka ndikuar që të rriten çmimet në konsum të ushqimit, që përbën të rrezikohet dhe thellohet varfëria. Edhe FMN-ja e ka vërtetuar këtë", u shpreh Thaçi. Ministri Shala e ka kundërshtuar këtë hulumtim, duke thënë se këto të dhëna nuk janë të sakta. Sipas tij, MTI-ja ka bërë një studim me kompanitë vendore dhe të dhënat janë se kjo taksë e ka rritur prodhimin vendor.

Hamza nënshkruan vendimin për reduktimin e normave tatimore për kafshët dhe shpendët e gjalla

PRISHTINË, 26 QERSHOR (ER) - Në kuadër të reformave fiskale për përmirësimin e kushteve të favorshme të të bërit biznes, ministri i Financave, Bedri Hamza, të mërkurën ka nënshkruar vendimin për reduktimin e normës së Tatimit të Vlerës së Shtuar nga 18 për qind në 8 për qind për kafshë të gjalla dhe shpendë të gjallë sipas kodeve tarifore të


Doganës nga 0102 deri në kodin tarifor 0106. Në njoftimin e kësaj ministrie është theksuar se ky vendim është në vazhdim të vendimeve të shumta të cilat janë marrë nga ministri Bedri Hamza në politika fiskale për lirim nga tatimi doganor dhe akcizës që kanë për qëllim krijimin e kushteve të favorshme për të bërë biznes, përkatësisht për zhvil-

lim të prodhimit në vendin tonë, me qëllimin e vetëm të zhvillimit të mirëqenies së qytetarëve të Republikës së Kosovës. "Ministri i Financave do të vazhdojë edhe më tutje me reformat në politikat fiskale, për ta rritur zhvillimin e sektorit privat në Kosovë, si faktor kyç i zhvillimit ekonomik të vendit", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Financave.



Nisi punimet konferenca shkencore ndërkombëtare në UPZ

PRIZREN, 26 QERSHOR (ER) - Konferenca e katërt shkencore ndërkombëtare "The East of the West and West of the East", e mbajtur më herët në Prizren, Pragë dhe Ohër, sivjet përsëri është duke u mbajtur në Prizren, kryeqytetin kulturor të Ballkanit. Kjo konferencë është organizuar nga Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren në bashkëpunim me Universitetin Trakya, Universitetin Hakari si dhe Universitetin e Muglas. Për pjesëmarrje në konferencë janë dërguar gjithsej 112 abstrakte shkencore, prej të cilave janë pranuar gjithsej 76 abstrakte me autorë të vetëm si dhe bashkautorë. Pjesëmarrësit në këtë konferencë ndërkombëtare janë nga



Republika e Turqisë, e Shqipërisë, e Azerbajxhanit, si dhe nga Kosova. Rektori i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, Ismet Temaj, ka theksuar se organizimi për

herë të dytë i kësaj konference nga UPZ-ja është një dëshmi se ky universitet është duke ecur me hapa të sigurt drejt realizimit të objektivave dhe synimeve që ka. Ndërsa Shemsi

Morina, prorektor për mesimdhënie, çështje të studentëve dhe kërkime shkencore, ka theksuar se kjo konferencë nuk do të mund të organizohet pa ndihmën e pakursyer

të bordit, komitetit shkencor, në veçanti të profesorit Turul, si dhe profesorit tjetër, Serdan Kervan, të cilët, sipas tij, kanë bërë të pamundurën që çdo gjë të shkojë si duhet.

Nis ndërtimi i një çerdheje dhe një shkolle në Istog



ISTOG, 26 QERSHOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka vizituar të mërkurën Komunën e Istogut, ku ka marrë pjesë në ceremoninë e vënies së gurthemelit për ndërtimin e çerdhes në këtë qytet. Po ashtu, ai ka marrë pjesë edhe në ceremoninë e vënies së gurthemelit për ndërtimin e objektit të ri të Shkollës Filllore "Tre dëshmorët e shkollës shqipe" në fshatin Uçë të Istogut. Ministri Bytyqi fillimisht është takuar me kryetarin e Komunës së Istogut, Haki Rugova, me të

cilin ka nënshkruar edhe një memorandum bashkëpunimi për bashkëfinansim të ndërtimit të objektit të ri të shkollës në Llukavc të Epërm të kësaj komune. Me këtë rast, Bytyqi ka thënë se vetëm me një bashkëpunim të ngushtë me nivelin lokal, mund t'i arrijmë synimet për të pasur një standard të lartë të edukimit dhe arsimimit të fëmijëve tanë. Ndërsa në ceremoninë e vënies së gurthemelit të çerdhes, ministri Bytyqi ka thënë se ky investim po bëhet në kuadër të angazhimeve të mëdha që po

bën MASHT-i për të krijuar kushte dhe mundësi për rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin e hershëm. Edhe gjatë ceremonisë së vënies së gurthemelit të shkollës në Uçë, ministri Bytyqi ka përmendur përpjekjet e vazhdueshme të MASHT-it për të krijuar ambiente moderne dhe të përshtatshme për arsimim cilësor. "Vetë fakti se kjo shkollë mban emrin e tre dëshmorëve, tregon më së miri që populli ynë gjithmonë e ka dhënë edhe jetën për arsimin dhe gjuhën shqipe", ka thënë Bytyqi.

Asfaltohen dy rrugë në Gurbardh të Malishevës

MALISHEVË, 26 QERSHOR (ER) - Në fshatin Gurbardh të Malishevës janë asfaltuar 500 metra rrugë. Asfaltimi i dy rrugëve në këtë fshat është bërë në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës dhe realizimit të projekteve kapitale. Asfaltimin e rrugëve në këtë fshat e kanë parë nga afër nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, drejtori i Urbanizmit, Islam Vrenezi, të cilët janë shoqëruar edhe nga kryetari i fshatit, Bashkim Berisha.

Nënkryetari Berisha ka thënë se si komunë janë duke bërë rregullimin e rrugëve brenda lagjeve të fshatrave. "Këto investime janë pjesë e projekteve të parapara për investime kapitale dhe për rregullimin e infrastrukturës në të gjitha fshatrat e komunës sonë. Tani jemi duke investuar në rregullimin e rrugëve brenda lagjeve, pasi të gjitha fshatrat i kanë rrugët kryesore të ndërtuara", ka thënë Berisha. Ndërsa kryetari i Gurbardhit, Bashkim Berisha, ka thënë se asfaltimi i rrugëve ka rëndësi të madhe për banorët e këtij fshati, sidomos për fëmijët të cilët janë në shkollë.



Organizata zvicerane AQH ndihmon QKMF-në e Malishevës me mjete pune

Malishevë, 26 qershor (ER) - Organizata zvicerane AQH, e cila merret me sektorin e shëndetësisë, në kuadër të përkrahjes së vazhdueshme për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Malishevë, përsëri e ka përkrahur. Donacioni i fundit që AQH e ka sjellë për QKMF-në është në vlerë prej 2 000 eurosh në mjete pune. "Krahas trajnimeve të vazhdueshme, që AQH i ofron

stafit mjekësor në Malishevë, edhe donacionet në mjete të punës janë të vazhdueshme. Edhe ky donacion është në vazhden e përkrahjes së tyre për shëndetësinë në Malishevë", ka thënë drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Malishevës, Liridon Hoti, i cili ka falënderuar organizatën AQH e cila ka dhënë shumë për Malishevën.

Trumpi dhe Putini do të takohen në Osaka

MOSKË, 26 QERSHOR - Presidenti rus Vladimir Putin dhe presidenti amerikan Donald Trump do të takohen në margjina të Samitit të 20 vendeve më të industrializuara (G20), që do të mbahet nesër (e enjte) në Osaka të Japonisë, ka konfirmuar ndihmësi i Kremlinit, Yuri Ushakov. Takimi mes dy liderëve do të zhvillohet në kohën e rritjes së tensioneve rreth Teheranit. Trumpi është kërcënuar me sulme hakmarrëse ndaj Iranit, pasi e ka fajësuar atë për kryerje

të sulmeve në dy anije transportuese të naftës, derisa Irani ka rrezuar një dron mbikëqyrës amerikan.

Teherani ka mohuar përgjegjësinë për sulmet në tanke dhe ka thënë se droni i Shteteve të Bashkuara ka qenë duke fluturuar në hapësirën ajrore iraniane.

Traktatet për kontrollin e armëve, të cilat si Putini ashtu edhe Trumpi kanë kërcënuar se do t'i pezullojnë, do të jenë pjesë e diskutimeve mes të dy lid-

erëve, është thënë në një dokument të Kremlinit.

Ushakov ka thënë se liderët do të diskutojnë edhe për "stabilitetin strategjik dhe një varg konfliktesh rajonale", duke përfshirë Sirinë, Venezuelën dhe Iranin.

Uashingtoni në anën tjetër nuk ka konfirmuar datën e takimit. "Nuk do të jetë një samit zyrtar, mirëpo pritet të jetë bisedë që do të fokusohet fillimisht në aspektet e sigurisë rajonale, duke përfshirë Iranin, Ukrainën, Sirinë dhe Lindjen e Mesme", ka



thënë një zyrtar i lartë i administratës amerikane. Trumpi ka thënë javën e kaluar

se planifikon të takohet me Putinin në Samitin e G20-s në Japoni.

Robert Mueller do të dëshmojë para Kongresit në seancë të hapur

Prokurori Robert Mueller, pasi udhëhoqi një hetim dyvjeçar mbi ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhjet e vitit 2016 dhe pretendimet se presidenti Trump pengoi drejtësinë duke u përpjekur ta mbyllë hetimin, ka pranuar të dëshmojë në seancë të hapur para Komisionit Juridik dhe të Zbulimit në Dhomën e Përfaqësuesve muajin e ardhshëm



WASHINGTON, 26 QERSHOR - Prokurori i posaçëm, Robert Mueller, ka rënë dakord të dëshmojë në seancë të hapur para Komisionit Juridik dhe të Zbulimit në Dhomën e Përfaqësuesve muajin e ardhshëm.

Kryetarët e të dy komisioneve, Jerrold Nadler dhe Adam Schiff, njoftuan përmes një letre të martën vonë, se prokurori Mueller do të paraqitet më 17 korrik dhe se ata dhe të gjithë amerikanët mezi presin të dëgjojnë prej tij. Robert Mueller udhëhoqi një hetim pothuajse dyvjeçar mbi ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhjet e vitit 2016 dhe pretendimet se presidenti Donald Trump pengoi drejtësinë duke u përpjekur ta mbyllë hetimin.

Ai publikoi një raport, një version i redaktuar i të cilit u bë publik në muajin prill, që përfundoi se fushata e presidentit Trump nuk kishte bashkëpunuar me Rusinë gjatë zgjedhjeve, por nuk arriti të sillte një përfundim në lidhje me pengimin e drejtësisë, ka njoftuar voa.

Presidenti Trump ishte shumë kritik ndaj procesit, duke i cilë-

suar hetimet vazhdimisht si "ndjekje shtrigash". Ai reagoi shkurt pas njoftimit të së martës në rrjetin "Twitter" duke shkruar "keqtrajtim i presidentit". Komentet e vetme të prokurorit Mueller deri tash u bënë në një konferencë me gazetarë në muajin maj, gjatë së cilës ai lexoi një deklaratë të përgatitur që më parë dhe nuk pranoi asnjë pyetje.

Ligjvënësit Nadler dhe Schiff kishin lëshuar fletëthirrje që kërkonin detyrimin e prokurorit Mueller që të dëshmojë, duke shpjeguar se, ndërsa ata vënë në dukje dëshirën e prokurorit të posaçëm që është i mjaftueshëm raporti i tij me shkrim, publiku meriton të dëgjojë drejtpërdrejt jo vetëm për përfundimet e tij, por edhe për vetë hetimet. "Amerikanët kanë kërkuar të dëgjojnë drejtpërdrejt nga prokurori i posaçëm, në mënyrë që të mund të kuptojnë atë që ai dhe ekipi i tij hetuan zbuluan dhe vendosën rreth sulmit të Rusisë në demokracinë tonë, pranimin dhe përdorimin e kësaj ndihme nga ana e presidentit Trump dhe pengimin e hetimit të sulmit nga presidentit Trump dhe

bashkëpunëtorët e tij", shkruan në letrën e tyre ligjvënësit Nadler dhe Schiff.

Demokratët kanë kërkuar jo vetëm publikimin e më shumë informacioneve nga raporti i Muellerit, por kanë vazhduar të kërkojnë dëshmi nga Shtëpia e Bardhë dhe zyrtarët e fushatës së presidentit Trump, për të mësuar më shumë rreth asaj që ka ndodhur gjatë zgjedhjeve dhe në pjesën e parë të mandatit të presidentit. Republikanët i kanë kritikuar hetimet duke theksuar se

Kongresi duhet të ecë përpara. Ligjvënësi Doug Collins, përfaqësuesi kryesor në Komisionin Juridik, tha se shpreson që paraqitja e prokurorit Mueller "do t'i japë fund lojës politike të demokratëve të këtij komisioni në kurriz të taksapaguesve".

Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, mirëpriti gatishmërinë e Muellerit për të dëshmuar, duke vënë theksin te shqetësimet për zgjedhjet e ardhshme dhe duke nënvizuar se "është detyrë patri-

otike e ligjvënësve që t'i ndjekin faktet, në mënyrë që të mbrojmë demokracinë tonë". "Raporti i Muellerit zbuloi se rusët zhvilluan një sulm 'gjithëpërfshirës dhe sistematik' ndaj zgjedhjeve tona dhe zyrtarët më të lartë amerikanë të zbulimit dhe të zbatimit të ligjit kanë paralajmëruar se rusët do t'i sulmojnë përsëri zgjedhjet tona", tha ajo në një deklaratë. Megjithatë, fatkeqësisht, presidenti e quan atë një rreng dhe sugjeron se ai do ta mirëpriste ndërhyrjen ruse përsëri.

NATO-ja e shqetësuar nga veprimet destabilizuese të Iranit

BRUKSEL, 26 QERSHOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, përsëriti të mërkurën shqetësimin e tij për ato që ai i quajti "aktivitete destabilizuese" të Iranit në Gjirin Persik. Duke folur në Bruksel përpara një takimi të ministrave të Mbrojtjes të Aleancës, ai tha "ne duhet t'i shmangim llogar-

itë e gabuara në rajonin e Gjirit, sepse kemi parë sa e rëndësishme është që t'i shmangemi hyrjes në një situatë e cila mund të bëhet edhe më e rrezikshme dhe më e vështirë sesa gjendja që shohim sot".

Të 28 aleatët e Shteteve të Bashkuara po presin të dëgjojnë

nga sekretari i ri i Mbrojtjes në detyrë, Mark Esper, i cili po paraqet strategjinë amerikane për të detyruar Iranin nëpërmjet presionit ekonomik që ta rinegociojë marrëveshjen bërthamore ndërkombe-tare me Teheranin. Administrata e presidentit Trump u tërhoq nga kjo marrëveshje vitin e kaluar.



E rrallë

Macja që i mbijetoi larjes në lavatriçe

Kjo mace në ShBA i ka mbijetuar një rrotullimi 35-minutash në lavatriçe. E zonja e shtëpisë gjatë larjes së teshave në lavatriçe dëgjoji një zë dhe, kur e hapi lavatriçen, pa macen e katandisur. Macja menjëherë u dërgua në Qendrën Emergjente të Kafshëve në Minesota për shërim që kushtoi rreth 3 000 dollarë.



FOTO E DITES



Në qytetin e Nicës temperaturat të martën kanë arritur 33 gradë celsius. Por, pavarësisht prej temperaturave të larta, turistët e vizitojnë këtë vend. /AFP/

E jashtëzakonshme

Rezervuan online hotelin luksoz me pamje nga deti, e gjetën "të shkatërruar"

Nënë e bijë rezervuan një dhomë në një hotel me katër yje për pushimet e verës, por u shokuan nga ajo çfarë gjetën. Ato rezervimin e bënë online në faqen 'Booking.com' për një pushim të shkurtër në Izrael. Pasi bënë pagesën me 120 paund nata, ato zbuluan



se ndërtesa ku kishin rezervuar ishte braktisur, muret ishin thyer, dritaret nuk kishin xhama dhe nuk kishte energji elektrike.

BARSOLETA E DITËS



Njëri e pyet kolegun polic:

- Çfarë ke? Të ka ndodhur gjë?

- Edhe po më pyet a? Nesër kam test të gjakut e nuk kam mësuar asgjë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)

"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan

Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00

"X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain

Regjia: Simon Kinberg



Në ora 20:00

"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson

Regjia: F. Gary Gray



Ne ora 22:00

"M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown

Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



DASHI

Mbase mbi disa argumente që nuk keni


dijeni nuk keni pse debatoni. Do të tregonit që jeni të painformuar mirë lidhur me tema të caktuara.



DEMI

Një ditë e tërë në shoqërinë e vetes suaj sot

mund t'ju bëjë veçse mirë. Ju shijon të ecurit në rrugë shpenguar ose vajtja në aktivitete kulturore.



BINJAKËT

Edhe pse nuk keni gjithçka nën kontroll, kjo nuk do të thotë

që nuk menaxhoni dot punën tuaj. Jeni mjaft korrekt kur bëhet fjalë për profesionalizëm.



GAFORRJA

Nuk mund të lejoni që personat tuaj të afërt

të jenë neglizhentë me një çështje të caktuar. Falë ndërhyrjes suaj gjërat do të rregullohen.



LUANI

Keni shumë gjëra që kanë lidhje me

administratën sot për të mbyllur dhe do t'ju duhet ta nisni ditën më herët se zakonisht.



VIRGJËRËSHA

Nëse doni t'i vini nën presion personat

afër jush ose bashkëpunëtorët, sot do t'ia arrini qëllimit. Nuk është e thënë që kjo sjellje është e mirë.



PESHORJA

Njerëzit pranë jush e kanë harruar sa

person i bukur jeni në shoqëri. Kjo sepse ju jeni shmangur prej kohësh kontaktit me të tjerët.



AKREPI

Kushtet komode që keni pasur i keni rifituar

kohët e fundit dhe kjo gjë ju pëlqen të zgjasë sa më shumë. Do të kërkonit kontakte të reja.



SHIGJETARI

Keni rifituar terrenin e humbur në një

çështje personale. Kjo gjë ju ka bërë të bindeni që mjafton pak këmbëngulje dhe mund t'ia dilni.



BRICJAPI

Jeni pak të ndrojtur në kontaktin e parë

me të panjohurit. Më pas bëheni shumë shpejt protagonistët e situatave.



UJORI

Nëse nuk doni që dikush t'ju vërë

me shpatulla për muri dhe t'ju kërkojë llogari, duhet patjetër të përfundoni atë që keni nisur deri në mesditë.



PESHQIT

Ditët e fundit keni hasur në pengesa që

nuk ju kanë lejuar të shihni qartë sa i përket gjendjes suaj të rënduar shpirtërore.

Leonardo DiCaprio goditet në fytyrë nga një top volejboli



Derisa po luante volejboll me shokët në Malibu gjatë fundjavës, aktori 44-vjeçar Leonardo DiCaprio është fotografuar derisa një top e ka goditur në fytyrë. Për fansat që u shqetësuan,

DiCaprio ka shpëtuar pa asnjë lëndim. Aktori ka qenë së fundmi në Kanë të Francës ku e ka promovuar filmin e ri "Once Upon a Time In Hollywood", ku luan bashkë me Brad Pittin dhe Margot Robbien.



Emma Stone pëson lëndim në shpatull

Emma Stone po rimëkëmbet pas lëndimit që pësoi kohën e fundit. Aktorja 30-vjeçare ka dëmtuar shpatullën pasi rrëshqiti në dyshemenë e një shtëpie, ka treguar një burim për "People". Nuk dihet nëse inci-

denti ndodhi në shtëpinë ku 30-vjeçarja po qëndronte për ta xhiruar filmin e ri në Londër ose në një shtëpi të një miku. Raportohet se lëndimi i ka ndikuar aktore në punë pasi mjekët i thanë të pushojë për dy muaj.

Camila Cabello ndahet nga i dashuri?



Thuhet se Camila Cabello dhe i dashuri i saj Matthew Hussey janë ndarë. Raportohet se çifti u nda pas 18 muajve bashkë. "Marrëdhënia e Camila's me Matthew u prish dy javë më parë. Ishte vendim i ndërsjellë për t'iu dhënë fund gjërave, por ata kanë

kaluar shumë kohë së bashku dhe duan të jenë miq, pavarësisht ndarjes", ka treguar një burim për "The Sun". Lajmi erdhi menjëherë pasi Camila publikoi prapaskenat e klipit për këngën "Senorita" në bashkëpunim me shokun e ngushtë Shawn Mendes.

Chris Pratt dhe Katherine Schwarzenegger shkojnë në Hawaii për muajin e mjaltit



Chris Pratt dhe Katherine Schwarzenegger po e kalojnë muajin e mjaltit në Hawaii. Udhëtimi i tyre romantik vjen vetëm dy javë pasi çifti u martua në një ceremoni shumë intime. Para se të niseshin për këtë udhëtim në

Hawaii, Pratt dhe Schwarzenegger kaluan kohë më familjen e tyre, përfshirë edhe djalin gjashtëvjeçar të Prattit, Jack. Hawaii nuk është diçka e re për 40-vjeçarin Pratt pasi ai ka punuar atje kur e ka përfunduar shkollën e mesme.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Fazliu: E kalojmë edhe Santa Coloman

Astrit Fazliu ka thënë se Feronikeli me plot meritë e kaloi pengesën e parë në Ligën e Kampionëve, kurse i bindur është se do ta mposhtë edhe kundërshtarin e dytë, Santa Coloman në finalen që zhvillohet të premten në stadiumin "Fadil Vokrri". "Ndeshja e dytë finale do t'i ketë vështirësitë e veta, por sikurse në ndeshjen e parë do të hyjmë seriozisht dhe besoj se do ta kalojmë edhe Santa Coloman, e cila është kundërshtarë e fitores. Jemi optimistë se mund të shkojmë shumë lart në këto gara për faktin se kemi një ekip cilësor dhe më pak fat mund të arrijmë suksese të mëdha", ka deklaruar Fazliu



Feronikeli pati pak shikues, por nuk i ul çmimet e biletave

Pavarësisht se numri i shikuesve të martën në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë ishte i vogël për ta përcjell ndeshjen Feronikeli - Lincoln si pasojë e çmimit të lartë të biletave, Feronikeli nuk i ndryshon çmimet e biletave as për ndeshjen finale. Kundërshtarë e skuadrës nga Drenasi në finale është Santa Coloman. "5 euro për zonat Përmendim dhe Lindje, kurse 10 euro për Zonën VIP", thuhet në njoftimin e Feronikelit. Biletat do të dalin në shitje ditën e enjte nga ora 14:00 në këto pika të shitjes: Sheshi 'Zahir Pajaziti' në Prishtinë, Sheshi 'Fehmi Lladrovc' në Drenas, restorant 'Dijamant' në Drenas dhe pizzeria 'Dijamant' në Komaran. Ndërkaq të premten biletat shiten vetëm te stadiumi "Fadil Vokrri" në Prishtinë.

EPOKA E RE VETON ZYMBERI

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Skuadra kampione dhe fituese e Kupës së Kosovës në futboll, Feronikeli, e mposhti të martën në mbrëmje, në stadiumin "Fadil Vokrri", Lincoln Red Imps me rezultat minimal 1-0, në ndeshjen e gjysmëfinale në paraleliminatoret për Ligën e Kampionëve. Sulmuesi Astrit Fazliu ka thënë të mërkurën për "Epokën e re" se "Nikli" fitoi me meritë të plotë ndaj

një ekipi të fortë siç është Lincoln Red Imps. "Feronikeli ia doli për mrekulli kundër një ekipi të fortë siç është Lincoln. Mund të them se paraqitja jonë ishte e mirë dhe me meritë shënuam fitore që na mundësoi kalimin në finale. Përveç golit të shënuar, kemi pasur edhe raste të tjera për shënim, por dihet se Liga e Kampionëve është garë më e vështirë dhe mjafton edhe një gol për ta arritur synimin", ka thënë Fazliu, i cili ishte ndër futbollistët që ka vrapuar më së

shumti në këtë ndeshje nga skuadra e "Niklit". Ish-sulmuesi i Dritës, Ferizajt dhe Prishtinës foli edhe për ndeshjen e dytë finale e cila zhvillohet të premten në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 20:45. Fazliu, që ka një përvojë të madhe si futbollist, e vlerëson maksimalisht skuadrën e Santa Colomas, por beson se Feronikeli do të dalë triumfues. "Ndeshja e dytë finale do t'i ketë vështirësitë e veta por ne, sikurse në ndeshjen e parë, do

të hyjmë seriozisht dhe besoj se do ta kalojmë edhe Santa Coloman, e cila është një kundërshtarë e fitores. Jemi optimistë se mund të shkojmë shumë lart në këto gara për faktin se kemi një ekip cilësor dhe me pak fat mund të arrijmë suksese të mëdha", ka deklaruar Fazliu. Duhet cekur se kampionia e Andorrës, Santa Coloma, në finale u kualifikua pas fitores ndaj kampiones së San Marinos, Tre Penne.


Rrahmani: Hap i madh për mua transferimi në Itali

VERONË, 26 QERSHOR - Mbrojtësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Amir Rrahmani, është prezantuar sot te skuadra e Hellas Veronas. Ish-mbrojtësi i Drenicës ka kryer vizitat mjekësore dhe ka nënshkruar kontratë për skuadrën nga Seria A. Thuhet se Rrahmani i ka kushtuar Veronës 2.1 milionë euro, të cilin e bleu nga Dinamo Zagrebi. Ndërsa mbrojtësi në fjalë ka luajtur edhe për Lokomotivan, Splitin, Partizanin e Tiranës dhe Drenicën nga Skenderaj. Mbrojtësi i "Dardanëve", ka thënë se ndihet shumë i lumtur që është transferuar në elitën e futbollit italian. "Është hap i madh për mua të transferohem në Itali, veçanërisht në Serinë A dhe në Hellas Verona. Shpresoj të kem fillim të mbarë dhe të bëj ndeshje të mira dhe një sezon të mirë personalisht dhe me klubin. Forza Hellas!", ka thënë Rrahmani.



Behrami mbetet pa medalje në Lojërat Evropiane

MINKS, 26 QERSHOR - Boksieri i Kosovës, Patriot Behrami, nuk ka arritur ta kalojë edhe pengesën Lorenzo Sotomayor, nënkampionin olimpiq "Rio 2016" dhe kampionin tanishëm nga Lojërat Evropiane "Baku 2015". Behrami e ka dhënë maksimumin, por vendimi i gjyqtarëve ishte në të mirë të kundërshtarit të tij. 19-vjeçari dëshmoi se është shpresë e madhe e boksit të Kosovës. Arritja në tetë boksierët më të mirë nga 32 pjesëmarrës në Lojërat Evropiane "Minsk 2019" është sukses i madh për boksierin Behrami. Ndërsa gjyqtari ndërkombëtar i pingpongut, Jeton Beqiri, e ndau me sukses drejtësinë në Lojërat Evropiane "Minsk



2019". Beqiri ka ndarë drejtësinë në dy gjysmëfinale të disiplinës individuale, atë të meshkujve ndërmjet Jonathan Groth (Danimarkë) - Lei Kou (Ukrainë) dhe atë të femrave mes Lian Ni Xia (Luksemburg) dhe Lu Fu (Portugali).

Gjilani 'blindon' Kastratin, transferon Dautajn

GJILAN, 26 QERSHOR - SC Gjilani është treguar skuadër aktive të mërkurën pasi arriti marrëveshje të re me kapitenin e skuadrës, Ylber Kastratin, i cili do t'i vijojë paraqitjet në ekipin kuq e bardh. Kastrati është pjesë e

Gjilanit prej më shumë se 10 vjetësh dhe me marrëveshjen e re ai do t'i mbrojë ngjyrat e kësaj skuadre edhe për dy vjet të tjera. Gjilani, përveç rinovimit të kontratës me këtë futbollist, ka arritur marrëveshje edhe me

Qëndrim Dautajn, i cili në kampionatin e fundit ka mbrojtur ngjyrat e Ferizajt. Në fakt, për Dautajn është një rikthim në skuadrën e Gjilanit, pasi ai para disa edicioneve ishte pjesë e Gjilanit. Futbollisti karrierën e

në vendlindje me skuadrën e Deçanit ku dhe u afirmua në futbollin e Kosovës. Paraqitjet i vazhdoi edhe për disa skuadra të ndryshme: Besën e Pejës, Feronikelin, Flamurtarin dhe Llapin.



Mavraj rikthehet në Greuther Furth

Mërgim Mavraj i ka dhënë fund aventurës me Ingolstadtin, duke firmosur me skuadrën e re. Kapiteni i Kombëtares ka vendosur të rikthehet te skuadra e Greuther Furthit që militon në Bundesligën 2. 33-vjeçari ka qenë pjesë e 3 sezoneve më parë, teksa

më pas u transferua te Kolni. Pas dështimit me skuadrën e Ingolstadtit, e cila ra në kategorinë e tretë gjermane, mbrojtësi i Kombëtares do të kërkojë të rikthehet në formën e dikurshme. Kujtojmë që Mavraj iu bashkua Ingolstadtit në gjysmën e dytë të

sezonit, pasi më herët ishte pjesë e Arisit në kampionatin grek. Me Greuther Furthin shqiptari ka firmosur kontratë dyvjeçare, ndërkohë që lajmi për rikthimin e tij në shtëpi është konfirmuar nga vetë klubi gjerman, nëpërmjet një njoftimi në faqen zyrtare.



O'Connell ofron mbështetje për ndeshjen Angli - Kosovë

Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruiari O'Connell, ka ofruar mbështetje në lidhje me pajisjen e vizave për ndeshjen që Kosova e zhvillon në shtator si mysafire e Anglisë. Ai konfirmoi se do të jetë gjithmonë afër Përfaqësueses së Kosovës

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka prituri në takim ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruiari O'Connell. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe anëtarja e KE-së, Vjollcë Krasniqi, sekretari i përgjithshëm Eroll Salihu dhe drejtuesit e grupit të tifozëve "Dardanët".

Kryetari Ademi i shprehu falënderime ambasadorit O'Connell për mbështetjen që i ka dhënë Kosovës në të gjitha aspektet, e veçmas për përkrahjen dhënë Përfaqësueses së Kosovës në çdo ndeshje që ka luajtur në stadiumin "Fadil Vokrri". Ndërkaq, ambasadori O'Connell i përgëzoi drejtuesit e FFK-së për punën e deritashme dhe për sukseset e arritura jo vetëm me Përfaqësuesen A, por edhe me ekipet e tjera të grupmoshave, pastaj për organizimin fantastik të ndeshjeve dhe për sjelljen e shkëlqyeshme të tifozëve.

Më tutje, ambasadori O'Connell e ka vlerësuar si storie të suksesit FFK-në, duke uruar që rezultatet pozitive të Përfaqësueses, por edhe klubeve, do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, teksa ka premtuar se gjithmonë do të jetë afër Përfaqësueses së Kosovës, pasi tashmë edhe djali i tij është bërë



një fans i madh i "Dardanëve". Gjatë këtij takimi u bisedua edhe për çështjen e vizave dhe për lehtësimin e procedurave për tifozët dhe stafin për shkuarjen në Angli për ndeshjen e muajit shtator. Temë bisede ishte edhe ndeshja e kthimit në muajin nëntor kundër Anglisë, e ku të dyja palët vlerësuan se është një rast shumë i mirë i promovimit të kulturës dhe mikpritjes së Kosovës për tifozët anglezë. U diskutua edhe për organizimin sa më të mirë të ndeshjeve të klubeve në rast se Feronikeli dhe Prishtina kalojnë në rrethin tjetër të garave evropiane, me ç'rast do të

takoheshin me klubet britanike, TNS dhe Glazgou Rangers. Edhe për këtë çështje ambasadori u shpreh i gatshëm të ndihmojë për lehtësimin e procedurave për pajisje me viza, njëherësh kërkoi të bëhet një organizim sa më i mirë edhe nga klubet dhe autoritetet lokale që mikpritja për tifozët të jetë në nivelin më të mirë. Në fund, presidenti Ademi dhuroi një pllakate dhe një fanellë të Përfaqësueses për ambasadorin O'Connell. Dhuratë për ambasadorin kishte përgatitur edhe kryetari i "Dardanëve", Lulzim Berisha.

Leclerc: Prisja një Ferrari më të shpejtë

MONACO, 26 QERSHOR - Charles Leclerc ka mbetur i zhgënjyer nga ky sezon i deritanishëm i makinës Ferrari. Si ai ashtu edhe Sebastian Vettel nuk kanë fituar asnjë garë. Madje edhe kur kanë qenë shumë pranë triumfit, nuk kanë mundur ta shijojnë atë. Leclerc u la në baltë nga makina Ferrari në garën e dytë sezonale, në Bahrein. Ndërsa Vettelit iu hoq fitorja në Kanada, pas penalizimit që mori nga komisarët e pistës. Po në 6 garat e tjera? Një dominim total i Mercedesit me Hamiltonin e Bottas, që kryesojnë Botërorin e Formulës 1. "Mercedesi është shumë i shpejtë dhe nuk po arrijmë të duelojmë fort me të në çdo garë. Në fakt, kam prituri një makinë Ferrari ndryshe këtë sezon. Edhe pse jemi duke bërë një paraqitje të mirë, jo mjaftueshëm sa për të fituar në çdo garë. Shpesh jemi të detyruar t'i menaxhojmë gomat dhe kjo na humb shumë pikë në garë", ka thënë Leclerc.



SHKURT

U21-shat e përfundojnë me sukses fazën e parë

Përfaqësuesja e Kosovës U21 të mërkurën e ka përfunduar fazën e përgatitjes kondicionale për Kampionatin Botëror që mbahet në Spanjë prej 16 deri më 28 korrik. Faza e parë është vlerësuar shumë e suksesshme, ndërsa stërvitjet tekniko-taktike zhvillohen prej të premtes në Prishtinë, kurse do të ushtrohet nga dy herë në ditë. Deri më tani Përfaqësuesja e juniorëve ka ushtruar në Banjë të Pejës.

Silva konfirmon largimin nga City

Mesfushori i Spanjës, David Silva, ka konfirmuar largimin nga kampionët e Premierë Ligës, Manchester City, në përfundim të sezonit të ardhshëm. "Ky është i fundit. 10 vjet për mua janë mjaftueshëm. Është koha e përkryer. Klubi është duke biseduar edhe për dy vjet të tjera në kontratë, mirëpo unë vendosa që 10 vjet janë të mjaftueshëm", ka thënë Silva.

Cillesseni largohet nga Barça, shkon te Valencia

Portieri Jasper Cillessen është edhe zyrtarisht lojtar i Valencias. Klubi njoftoi marrëveshjen me portierin holandez përmes një videoje të veçantë në rrjetet sociale dhe ky transferim i jep fund sagës së Cillesseni i cili prej kohësh kërkonte largimin nga Barcelona. Kjo lëvizje është pjesë e një operacioni të gjerë mes dy klubeve ku, krahas Cillessenit, te Valencia pritet të zbarkojnë edhe mesfushorët Denis Suarez e Rafinha, ndërsa drejt katalansve do të shkojë portieri Neto.

Realit synon Pogban ose Van De Beekun

Real Madridi është duke punuar për transferimin e Paul Pogbas nga Manchester Unitedi. Drejtuesit e Realit kanë hartuar edhe planin B nëse nuk arrijnë transferimin e mesfushorit francez. Mediet kanë zbuluar se mesfushori i Ajaxit, Donny van de Beek. 22-vjeçari pëlqehet nga trajneri Zinedine Zidane, por edhe nga presidenti Florentino Perez. Në edicionin e fundit Van De Beek ka regjistruar 57 paraqitje për Ajaxin dhe ka shënuar 17 gola.

Ish-agjenti i Salas rrezikon të përfundojë në burg

Të gjithë e njohin historinë e famëkeqit Emiliano Salas, i cili humbi jetën pas një aksidenti ajror teksa po fluturonte nga Nantes drejt Cardiffit, që ishte edhe ekipi i tij i ri. Pikërisht agjenti që e dërgoi argentinasi për të firmosur në Cardiff dhe që rregulloi gjithçka për kalimin e sulmuesit në Premierë Ligë, akuzohet për mashtrim. Ujll MeKej rrezikon dy vjet burg dhe do të paraqitet në gjykatën e Manchesterit me 31 korrik, ku do të përballet me dy akuzat për mashtrim. Gjithashtu, MeKej akuzohet edhe për kërcënime ndaj drejtuesve të Cardiffit, ku i është drejtuar këtyre të fundit se do t'i vriste të gjithë.



EPOKA E RE	ANJE E VJETËR SPANJOLLE ME VELA	LLOJ DRURI I ÇMUESHËM QË PËRDORET PËR VEGLA MUZIKORE (shq.)	KËNGËTARJA ANGLEZE TIKARAM	FUTBOLLISTI SAMUEL ...	KËNGËTARJA BRITANIKE HALLIWELL	ZANORE	KËNGËTARJA ME FAMË BOTËRORE BLACK	KAMPIONI, ASI (Sport)	KASPERSKY INTERNET SECURITY	EPOKA E RE	LLOJ ZOGU KËNGËTAR
QË SHPREHET NË MËNYRË TË PRERË E TË QARTË										BASHKËT. THEMELUESI I TURQISË MODERNE MUSTAFA	
FUTBOLLISTI ITALIAN IGNAZIO (MILAN)						GJINI E KRIJIMTARISË LETRARE					
QË PËRMBAN RËRË; QË ËSHTË I MBULUAR ME RËRË						PELLG I HAPËT PËR TË GRUMBULLU-AR UJË KALIUM, SULFUR, TON					
NË RREGULL (bised.)				PORTIERI KASILLAS PËRJEKJE PËR TË VRARË NJË VEPRIMTAR				MARK ANTONI MUAJ I VITIT			
E DREJTA E SECLIT PËR TË SHFAQUR MENDIMIN NË KOHËN E ZGJEDHJEVE					SKIATOR EMY ROSUM						
E NDESHA PAPRITUR DIKË								KËNGËTARJA ... FARA MURG I VETMUAR			
SËMUNDJE E RËNDË NGJITËSE (pashq.)			EDI RAMA VEPRIMTARI ... ÇELA (shq.)			BASHKËT.	GAZ I PANGJYRË DHE PA ERË ALYSSA MILANO				
EPOKA E RE	POETI NË FOTO	MJET FLUTURIMI QË LËVIZ ME SHPEJTËSI TË MADHE	HYJNIA E DASHURISË NË MITOLOGJINË ROMAKE	AKTORI HOLLIVUDIAN ... STILLER	GJËMË, E KEQE E MADHE QË I BËHET DIKUJT	ZANORE FORMË E TË HYRAVE SHITËTORE	DY BASHKË-TINGËLLORE ZHANËR FILMIK		BIMË QË KAVLERA TË MËDHA USHQIMORE "UDAYTON "		
KARROCË E HAPUR ME KATËR RROTA E TËRHEQUR PREJ KUJASH (sh.shq.)											AKTORJA & MODELJA AMERIKANE WILDE
SIGURESA ELEKTRIKE						DUET MUZIKOR KONTROVERS (fem.)					
PIKTURAT KISHTARE						KRYEQYTETI I ARABISË SAUDITE			RYSHFET		
FOSFOR, ERBIUM				PLUHUR I IMËT QË BËHET DUKE BLUAR DRITHIN (shq.)				BËRTHAMOR	MOTOÇIKLETA LARAGAN		
ISH ATLETJA ... MERLIN				FUTBOLLISTI TURK BELOZOGLU KËNGA QË I KËNDOHET TË DASHURËS ME KITARË NËN DRITARE			ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHEARER HOV, VRULL			"K" në mes të dy "V" "KALJARI"	
DANTE ALIGHIERI			DY BASHKË-TINGËLLORE QYTET NË GJERMANI		KËNGËTARJA E SHQUAR FRANKLIN KASOLLE E BARINJVE (shq.)						ZANORE BASHKË, ME
BASHKËT.		BETIM LLOJ BIME QË BËN KOKRRA TË VOGLA E TË THARA			DY BASHKË-TINGËLLORE I MITUR		LINDSEY OIL REFINERY BASHKËT.			SHTET NË EVROPË VITI I RI KINEZ (pashq.)	
I TURPËROJ						POTERA LLOJ VEGLA MUZIKORE				DY ZANORE SIGURIM I GJËRAVE TË NEVOJSHME PËR JETESË	ORGANIZATË EKSTREMISTE PALESTINEZE
XEHEROR						BEREQETI MODEL I ZVOGËLUAR I NJË OBJEKTI					DY BASHKË-TINGËLLORE KUVENDI I ATHINASVE TË LASHTË
DY BASHKË-TINGËLLORE			AGJËRIM (krah.) GJYMTYRË E TRUPIT				ELEKTRODA E POLIT NEGATIV TRUP GJEOMETRIK				ANDORA REGJISORJA JONË ELEZI
KËNGËTARJA NDOCI					SHTET NË AZI FILM I YNI "... ISHIN KATËR"						
EPOKA E RE	KLUB FUTBOLLI NË HOLANDË 3.14 (Mat.)					KËNGËTARI I FAMSHËM AMERIKAN ISMET PEJA					QYTET I MADH NË ITALI NË ÇFARË SASIE
KUSARI						FUTBOLLISTI FETAHU (shq.) ZANORE					EMËR YNI DJALI ZANORE
U ARRATISA NGA BURGU				PRAPË			AKTORJA ME FAMË BOTËRORE BECKINSALE (orig.)			AMPER, SILIC	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Agjencia Pyjore e Kosovës
Agjencia za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency

Sektor i Burimeve Njerëzore
Kancelarija osoblja i razvoja ljudskih resursa
Office of Personnel and Human Resources Development

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës NR.03/L-149 dhe nenin 22, paragrafi 4 të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, miratimit përmes SIMBNJ të pozitës nga MAP me datë 25.06.2019 bënë:

RISHPALJEN E KONKURISIT PËR KËTË VEND PUNE

Titulli i pozitës: Zyrtar/e për Arkiv 1
Ref: APK-08/19
Njësia organizative: Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
Vendi i punës: Prishtinë (1)
Nëpunësi Mbikëqyrës: Udhëheqësi i Sektorit për TI dhe Logjistikë
Kategoria funksionale: Niveli tekniko-administrativ
Grada e pagës (Koefficienti): Grada 10, Koefficienti 6
Lloji i pozitës së punës: E Jokatërre (e përkohëshme),
Kohëzgjatja e periudhës provuese: tre muaj (3)muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pranon dokumentet dhe lëndët për arkivim dhe kujdeset për arkivimin e tyre në përputhje me procedurat ligjore;
- Kujdeset për sistemimin dhe mbajtjen azhure të lëndëve arkivore, si dhe propozon udhëzues të nevojshëm për funksionimin e arkivit;
- Mirëmban arkivin e veçantë për rastet e detajuara specifike dhe ruan paprekshmërinë e informatave;
- Përkujdeset për seleksionimin e rregullt të lëndës arkivore;
- Bënë administrimin, pranimin dhe procedimin fizik dhe elektronik të shkresave (dokumente) zyrtare;
- Mban kontakte të vazhdueshme me institucionet e arkivit të Kosovës, me qëllim të dorëzimit të lëndëve arkivore arkivit kompetent pas kalimit të afatit;
- Ndërmerr veprime tjera të nevojshme për funksionimin sa më të mirë të ligjit mbi lëndën arkivore të Kosovës;
- Koordinon punën me nëpunësin që merret me postën për shpërndarjen e postes ,shkresave jashtë dhe brenda institucionit;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Shkathësitë kyçe, aftësitë dhe përvoja :

- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative.
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel) ,
- Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik
- Zotësi për punë në mjedisë shumetnike,
- Aftësi për përgatitje të raporteve, shkresave, kërkesave dhe informatave zyrtare,
- Gatishmëri dhe pedanteri në sistemimin dhe arkivimin e shkresave dhe dokumentacionit zyrtar,
- Korrektësi në mbajtjen e informacioneve dhe mos publikim e tyre pa autorizim
- Të mos jetë i gjykuar për veprë penale me vendim të formës së prerë si dhe të mos ketë të iniciuar aktakuzë të plotfuqishme hetimore penale,

Nëse kandidati-ja ka punuar apo punon në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës:

- Të ketë vlerësime pozitive të punës në dy (2) vite e fundit nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë
- Të mos jetë në procedurë disiplinore dhe të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në tri (3) vite e fundit.

Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë pozitë:

- Diplomë Universitare, Fkulteti Juridik, Fakulteti i shkencave matematiko-natyrore pa përvojë pune, ose shkollë e lartë me së paku dy (2) vite përvojë pune

Procedura e Konkurrimit:

Është e hapur edhe për kandidatë jashtë Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës.

Data e rishpalljes së konkursit: 27.06.2019

Data e mbylljes së konkursit: 11.07.2019

SQARIM :

Rishpallja e konkursit bëhet me arsyetimin se në shpalljen e mëparshme për këtë pozitë të publikuar me datë 17.05.2019 kjo procedurë e rekrutimit ndërprehet për shkak të mos pjesëmarrjes në testin me shkrim të kandidatëve që kanë hyrë në listën e ngushtë (vetem një kandidat prezent në test) dhe pamundësisë e vazhdim të kësaj procedure të rekrutimit me vetem një kandidat.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit NR.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Dokumentet duhet të jenë fotokopje përndryshe nuk kthehen.

